



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 4397 Prot.

Tiranë, më 25.5 . 2018

Nr. Identifikimi 361

Vendimi 22

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Emri i Subjektit: "A.S.Ç.Cr " sh.p.k.
Nr. NIPT-i: L37713901P
Adresa e selisë: Lagja Drita, Nr.15, Burrel.
Personi përgjegjës: Skender Cevani

Për të zhvilluar projektin: "Ndërtim dhe funksionim të Uzinës së ferro-kromit"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 4 /c. Instalime për prodhimin e metaleve bruto johekur nga xeherorët, koncentratet ose materialet dytësore (material që është nënprodukt) prej proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.

Vendndodhja: Fshati Suç, Bashkia Burrel, Mat, Qarku Dibër.

Sipërfaqja totale sipas certifikatave të pronësisë: 16 500 m²

Kapaciteti prodhues i ferrokromit: 19 300 ton/vit

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehën: Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Dibër shprehet: parimisht dakort.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguroa të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Zhvillimi i aktivitetit nuk prek zona të mbrojtura.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore të rëndësishme etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.3 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.4 Të bëhet kontroll i vazhdueshëm periodik i aparateve matës e sinjalizues, në rast avarish të bëhet riparimi i menjëhershëm i tyre.

- 4.5 Të instalohet impianti i mbrojtjes nga zjarri të Impiantit të prodhimit.
- 4.6 Të realizohet kapja e trajtimi i ujerave të ndotura të aktivitetit si dhe monitorimi i cilësise së tyre para shkarkimit në mjedis;
- 4.7 Subjekti te kujdeset për menaxhimi e mbetjeve te krijuara nga veprimtaria, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga Njësitë Vendore ose per rehabilitimin e karrieres. .
- 4.8 Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatet teknologjike të mbrojtjes së mjedisit.
- 4.9 Subjekti të realizojë menjëherë çdo ndërhyrje për pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndësh ndotëse në mjedis;
- 4.10 Të pastrohet menjëherë cdo rast ndotje e mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit;
- 4.11 Të realizohet lagia e sipërfaqes së kantierit dhe rrugët e brendshme për të evituar ngritjen e pluhurit gjatë levizjes së mjeteve etj.
- 4.12 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë rrugës, me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.13 Të ndërtohen kanalet dhe instalime për menaxhimin e ujërave të shiut.
- 4.14 Të instalohet impianti dhe infrastruktura e kapjes dhe trajtimit te ujerave teknologjike me ndertimin e dy ose me shume dampave ;
- 4.15 Të përmbushen normat e lejuara per instalimet qe do te vendosen ne lidhje me shkarkiet në mjedis (ajër dhe ujë)
- 4.16 Furnizimi me ujë për procesin teknologjik të bëhet me miratimin të organeve kompetente.
- 4.17 Subjekti te beje kujdes me shkarkimet e ujerave. Ndalohet ne menyre kategorike shkarkimi i tyre në përroin ekzistues pranë objektit.
- 4.18 Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kopetente.
- 4.19 Operacionet për zbatimin e projektit të përdorin infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.20 Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara, të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.21 Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqes së përcaktuar;
- 4.22 Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gomat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbuloohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave.
- 4.23 Të bëhet mbjellja e fidanëve përgjatë gjithë territorit të shfrytëzuar dhe veçanërisht në afërsi të objektit, me qëllim minimizimin e ndotjes së mundshme nga funksionimi i aktivitetit.
- 4.24 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.25 Ne raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.26 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara ne Deklarate.
- 4.27 Kompania duhet te respektoje gjithashtu edhe kushtet e vendosura te raportin e VNM-se qe eshte paraqitur ne aplikim si dhe te kete parasysh ligjin Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

4.28 Të zbatohen të gjitha masat parandaluese, për ndotjen e mjedisit, që parashikohen në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

4.29 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI


BLENDI KLOSI



aneksi 1. Harta me koordinatat



Figura 1. Pamja nga lart e Uzinen se Ferro-Kromit, Shoqeria A.S.C.Cr sh.p.k



Nr.	X	Y
1	4421084.55	4603530.58
2	4421209.73	4603518.50
3	4421287.67	4603442.75
4	4421207.82	4603343.74
5	4421047.07	4603377.61
6	4421091.32	4603494.83
7	4421003.91	4603433.20
8	4420981.38	4603375.49
9	4420990.44	4603344.62

Tabela 1. Koordinatat ne Gauss-Kryger